



Transmetohet nga
Enes ibën Maliku se i Dërguari i Allahut, Muhammedi, paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të,
ka thënë:

?????
????? ?????????? ????? ?????? ????????????? ?????? ?????? ??????????
?????? ?????? ?????.

“Të vdekurin e përcjellin tri gjëra; dy kthehen, ndërsa njëra mbetet me të. E përcjellin atë
familja, pasuria dhe puna e tij; kthehen familja dhe pasuria, ndërsa me të mbetet puna e tij.”

Hadithin e transmetojnë Buhariu dhe Muslimi.

Të nderuar vllazër!

Pra, njëra nga këto tri gjëra, të cilat e përcjellin njeriun deri në varr, është familja e tij.

Subhan-Allah!

Sa e çuditshme është kjo dunja, sa e poshtër është kjo dunja! Njërezit që më së shumti i do dhe
të duan, familja jote, më të afërmit tu, të fusin në varr dhe të largojnë nga ta!

Pasha Allahun, sikur t'u jepeshin atyre me miliona para, kurrë nuk do të pranonin që trupi yt i
vdekur të qëndronte me ta!

Njeriu në këtë dunja duhet ta zgjedh familjen e mirë, pra ta zgjedhë atë grua që i ndihmon atij të

bëjë vepra të mira, të cilat e kënaqin Allahun dhe e cila i edukon fëmijët sipas rregullave që i ka caktuar Allahu dhe i Dërguari i Tij.

Pra, njeriu i tillë është i lumtur. Ndërsa, ai njeri, familja e të cilit e pengojnë atë nga adhurimi i Allahut, është vërtetë i humbur.

Allahu thotë në Kur'an:

???

????????? ?????????? ?????????? ?? ?????????????? ?????????????????? ?????
????????????????? ??? ?????????? ?????????? ?????????? ?????????? ?????????? ??????????
????? ?????????????????? .

“O besimtarë, mos lejonit që pasuria dhe fëmijët tuaj t’ju largojnë nga të përmendurit e Allahut. Ata që e bëjnë këtë, do të humbin.” (El-Munafikunë: 9)

Në një hadith, i Dërguari i Allahut, paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të, ka thënë:

???? ?????? ??????: ?? ????? ??????

???????? ? ?????? ????

 ?????? ???????.

“Më erdhi Xhibrili dhe më tha: ‘O Muhammed! Jeto sa të duash, do të vdesësh, duaje kë të duash, do të ndahesh prej tij, puno çfarë të duash atë do ta gjesh!’”

Hadithin e transmetojnë Ahmedi dhe Hakimi.

Kur të vdesë njeriu, nuk do t’i bëjë më dobi familja e as pasuria e tij, përveç asaj familjeje e cila lutet dhe kërkon falje për të, dhe përveç pasurisë të cilën e shpenzon për hir të Allahut.

Allahu i Lartëmadhërisëm thotë në Kur'an:

????? ????? ?????????
 .????????? ?????? ?????? ?????????? ?????????? ??????????

“në Ditën, kur askujt nuk do t’i bëjë dobi as pasuria, as fëmijët, përveç atij që vjen me zemër të pastër tek Allahu!” (Esh-shuara’: 88. 89)

Në një hadith tjetër, i Dërguari i Allahut, paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të, ka thënë:

?????? ????? ??? ??

 ??? ?? ?????? ?????? ?? ??? ?????? ?? ?? ??? ?????? ?????? ?????? ??????

Phoca PDF

Shoqëruesi i tretë, gjegjësisht puna e njeriut asnjëherë nuk do të ndahet nga ai, do të jetë me të në varr, në Ditën kur do të ringjallemi dhe do të dalim para Allahut, të Plotfuqishmit, dhe në bazë të punës njeriut do t'i caktohet vendi i tij në xhennet apo në xhehennem.

Allahu i Lartëmadhërishëm thotë në Kur'an:

??
????????? ???????????? ???????????????

“Kush bën mirë, e bën për dobi të vet, e kush punon keq, punon në dëm të vet. Zoti yt nuk u bën padrejtësi robërve të Tij.” (Fussilet: 46)

Të gjitha bukuritë e kësaj bote do të kthehen dhe asnjëra nga to nuk do të qëndrojë me ty në varr, madje as familja jote.

E vetmja gjë, e cila do të qëndrojë vazhdimisht me ty është puna jote.

Andaj, kujdesu o vëlla dhe ti oj motër për këtë shok, i cili asnjëherë nuk do të ndahet nga ti!

Përpiqu që puna jote të jetë e mirë, në mënyrë që ajo të të shoqërojë në varr, atëherë kur do të ndahesh nga më të dashurit tu!

Disa nga selefët (të parët tanë) kanë thënë: “Puno për këtë dunja aq sa do të qëndrosh në të dhe puno për botën tjetër aq sa do të qëndrosh në të!”

Përgatiti: J. Kastrati - Shembulli.com

Bazuar në librin “Ed-dururu el-muntekatu min el-kelimat el-mulkati” të autorit Emijn Esh-Shekaui